

NË EMËR TË POPULLIT

Gjykata Themelore në Prizren – Departamenti i Përgjithshëm, gjyqtarja Teuta Krusha, me pjesëmarrjen e sekretares juridike Teuta Spahiu procesmbajtëse, në lëndën penale kundër të akuzuarit A. K. nga fshati L. Komuna e Prizrenit, për shkak të veprës penale lëndimi i lehtë trupor nga neni 188 par.1 nën par.1.4 të KPK, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Prizren – Departamenti i Përgjithshëm nën numrin PP/II.nr.2140-5/2016 të datës 16.11.2016, në shqyrtimin fillestar në praninë e prokurorit të shtetit Besim Susuri, të dëmtuarës L. F. nga Prizreni dhe të akuzuarit, me datë 06.11.2017, publikisht morri dhe shpalli këtë:

A K T G J Y K I M

I akuzuari:

A. K. nga i ati Xh. dhe e ëma D. e lindur B., i lindur me datë *data e lindjes...* në fshatin L. Komuna e Suharekës, tani me banim në fshatin L. Komuna e Prizrenit, ka të kryer shkollën fillore, me profesion mekanik, i pa martuar, baba i dy fëmijëve, me numër personal *numri personal...*, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, i gjendjes së varfër ekonomike.

ËSHTË FAJTOR

Se me datë 22.08.2016 rreth orës 17:00, në fshatin L. Komuna Prizren, i shkakton lëndime trupore të dëmtuarës L. F. e cila rezulton me dëmtim të përkohshëm të shëndetit, për shkak të një mosmarrëveshje që kishin në mes tyre, i akuzuari e sulmon fizikisht e godet me duar në pjesë të ndryshme të trupit, cilës i shkakton dhe atë: ndrydhje të indeve të buta të regjionit të krahut të dorës së majtë, të shuplakave të dy duarve dhe të kofshës së këmbës së majtë, të cilat lëndime kanë karakterin e lëndimit të lehtë trupor me pasojë të përkohshme të shëndetit.

Këso dore ka kryer veprën penale lëndimi i lehtë trupor nga neni 188 par.1 nën par.1.4 të KPK.

Andaj gjykata në kuptim të nenit 7, 41, 49, 50, 51, 73 dhe nenit 188 nën par.1.4 të KPK të akuzuarit i shqipton:

DËNIM ME GJOBË

- Në shumë prej 150 € (njëqind e pesëdhjetë euro), e cila shumë duhet të paguhet në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nëse dënimi me gjobë nuk ekzekutohet në afatin ligjor i njëjti do të zëvendësohet me 8 (tetë) ditë dënim burgu duke llogaritur 20 € për një ditë burg.

Obligohet i akuzuari që të paguaj shpenzimet e procedurës penale sipas llogarisë së gjykatës dhe atë në emër të ekspertit mjeko ligjore për ekspertizë shumen prej 20 €, si dhe në emër të paushallit gjyqësor të paguaj shumen prej 20 €, të gjitha këto në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi nën kërcënim të ekzekutimit të dhunshëm.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Prizren – Departamenti i Përgjithshëm, ka parashtruar aktakuzë nën numrin PP/II.nr.2140-5/2016 të datës 16.11.2016, kundër të akuzuarit A. K. nga fshati L. Komuna Prizreni, për shkak të veprës penale lëndimi i lehtë trupor nga neni 188 par.1 nën par.1.4 të KPK.

Gjykata në seancën fillestare në prezencën e palëve pasi që u lexua aktakuza nga ana e prokurorit të shtetit, i shpalsi dhe bëri prezantimin e të gjitha provave materiale në të cilat mbështetet aktakuza e parashtruar ndaj të akuzuarit, i njëjti deklaroi se ka kuptuar aktakuzën, nuk e kundërshton provat materiale dhe e ndjen veten fajtor për veprën penale me të cilën ngarkohet.

Gjykata në shqyrtimin fillestar ka vërtetuar këtë gjendje faktike.

Ditën kritike me datë 22.08.2016 në orët e pasdites rreth orës 17:00, në fshatin L. Komuna Prizren, i akuzuari A. K. për shkak të mosmarrëveshjes që ka pasur me të dashurën e tij – dëmtuarën L. F., sulmon fizikisht të njëjtën dhe shkakton lëndime trupore dhe atë: ndrydhje të indeve të buta të regjionit të krahut të dorës së majtë, të shuplakave të dy duarve dhe të kofshës së këmbës së majtë, të cilat lëndime kanë karakterin e lëndimit të lehtë trupor me pasoja të përkohshme të shëndetit.

Gjykata gjendjen e këtillë faktike ka vërtetuar nga pranimi vullnetar i fajësisë nga ana e akuzuarit për veprimet e përshkruar si në përshkrimin faktik të aktakuzës, me ç'rast edhe nuk ka administruar provat, pasi që nuk ka prova të papranueshme, po ashtu në tërësi është vërtetuar se i akuzuari ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimi të fajit për veprën penale me të cilën ngarkohet dhe ky pranim është bërë pa kushtëzim dhe vullnetarisht, sepse mbështet në fakte që përmban aktakuza, nga se i akuzuari prej fillimit të kësaj procedure ka qenë i njoftuar me të gjitha provat materiale të cilat i ka paraqitur përfaqësuesi i aktakuzës, të cilat prova asnjëherë nuk i ka kundërshtuar. Po ashtu gjykata ka ardhur në përfundim se pranimi i fajësisë nga ana e akuzuarit është bërë në pajtim me dispozitat e nenit 246 të KPPK dhe në veprimet e akuzuarit formohen të gjitha elementet e qenësore të veprës penale e përshkruar si në shqiptim të këtij aktgjykimi dhe për këtë ka vendosur që të akuzuarin të shpalli fajtor dhe të gjykoj në bazë të ligjit, duke vërtetuar përgjegjësinë penale juridike të tij.

Gjatë marrjes së vendimit mbi dënimin gjykata i morri parasysh të gjitha rrethanat në kuptim të nenit 73 të KPK, të cilët ndikojnë në llojin dhe lartësinë e dënimit, pasi që gjykata nuk ka gjetur asnjë rrethanë rënduese, ndërsa si rrethanë lehtësuese për të akuzuarin morri parasysh faktin se ka pranuar fajësinë dhe ka tregu bashkëpunimi me organet e drejtësisë, sjellja korrekte e akuzuarit gjatë zhvillimit të procedurës, pendimi për kryerjen e veprës penale, me të dëmtuarën raportet i kanë rregulluar, është i gjendjes së dobët ekonomike, është hera e parë që bie ndesh me ligjin, që nënkupton se gjer më tani ka jetuar në pajtim me ligjin, andaj bazuar në të gjitha këto gjykata i shqiptoi dënimin si në shqiptim të këtij aktgjykimi duke menduar se dënimi i shqiptuar i përgjigjet shkallës së përgjegjësisë së tij dhe se me këtë dënim do të arrihet qëllimi i dënimit që në të ardhmen të përmbahet nga veprimet e tilla, me bindje se është proporcionale me peshën e veprës penale për të cilën i akuzuari është shpallur fajtor.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale është marrë në kuptim të nenit 453 par.1 të Kodit të Procedurës Penale të Republikës së Kosovës.

Nga të cekurat më lartë u vendos si në shqiptim të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN
P.nr.2534/2016 të datës 06.11.2017

Procesmbajtësja
Teuta Spahiu

Gjyqtarja
Teuta Krusha

UDHËZIMI JURIDIK: Kundër këtij aktgjykimi pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga dita e pranimit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, nëpërmjet kësaj gjykate.